

VENDIM
Nr.365, datë 5.10.1991

PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË QIRASË SË OBJEKTEVE TË NDRYSHME TË
NDËRMARRJEVE E TË INSTITUCIONEVE SHETËTËRORE QË U JEPEN NË
PËRDORIM TË TRETËVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1) Qiraja për objektet e ndryshme të ndërmarrjeve e të institucioneve shetëtare që u jepen në përdorim të tretëve, bazohet në:

a) Masën e amortizimit të miratuar që shprehet në vleftë. Ajo llogaritet mbi vlerën e fillestare të objektit.

Kur objekti që jepet me qira nuk ka vleftë fillestare të regjistruar në kontabilitet, vlerësohet me komision të caktuar nga ndërmarrja ose institucioni që e administron atë, sipas manualeve të çmimeve në fuqi ose vleftës së objekteve me natyrë të përafërt. Për objektet e importit që nuk kanë çmime me pakicë, vleftës fillestare si më sipër i shtohet 50 për qind.

b) Kur objekti që jepet me qira është pasuri e paluajtshme dhe ndodhet mbi 5 km larg periferisë së qytetit ose qendres së banuar, masës së qirasë nuk i bëhet shtesë, kurse kur objekti ndodhet në periferi të qytetit ose qendrës së banuar, masës së qirasë, të llogaritur sipas shkronjës "a", i shtohet jo më pak se 10 për qind dhe, kur ndodhet në qendër, i shtohet jo më pak se 20 për qind.

Ky kriter nuk zbatohet për objektet për objektet e tjera që u jepen të tretëve e që janë pasuri e paluajtshme, si makineri e pajisje, vegla pune e të tjera, të kësaj natyre.

2. Kur objekti merret me qira nga të huajt, qiraja e përcaktuar sipas pikës "1" të këtij vendimi shumëzohet me koeficientin 10, kurse kur objekti merret me qira nga diaspora shqiptare ose nga personat e përbashkët ndërmjet personave fizikë a juridikë vendas e të huaj, koeficienti i shumëzimit është 5. Qiraja paguhet me dollarë ose me lekë, në varësi nga lloji i të ardhurave të realizuar.

3. Qiraja e përcaktuar sipas këtyre kriterëve mund të rritej më tej, kur objekti jepet me qira nëpërmjet ankandit.

4. Kur objekti jepet me qira për më pak se një muaj, qiramarrësi paguan qiranë para se ai të marrë objektin në përdorim.

5. Ndërmarrjet e institucionet e ndryshme shetëtare, për objektet që kanë në administrimin e tyre, kanë të drejtë t'u japin me qira objekte me lerë fillestare nën 100 mijë lekë personave juridikë e fizikë vendas e të huaj me afat deri në 5 vjet, duke marrë autorizimin e degëve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe e rajone.

6. Qiraja e arkëtuar nga qiramarrësi përfshihet në fitimin e ndërmarrjes ose të institucionit me drejtim ekonomik dhe përdoret sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat në fuqi. Në institucionet buxhetore këto të ardhura përdoren nga vetë ato.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
YLLI BUFI